



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1629/1 prot.

Tiranë, më 03 . 12 . 2025

V E N D I M

Nr. 286, datë 03 . 12 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 269, datë 21.11.2025, e paraqitur nga znj. G. M, kundër Ministrisë së Arsimit, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesja në mes të tjerash informon se: “Jam mësuese në ciklin e ulët pranë shkollës 9-vjeçare “Lekë Qokaj”, Cernicë, Tropojë. Në vitin 2014 kam përfunduar Fakultetin e Edukimit të Prishtinës, Dega Gjakovë, me studime 4-vjeçare (8 semestra, 240 kredite ECTS). Diplomat tona janë njohur nga Ministria e Arsimit me titull “Bachelor”, ndërkohë, kolegë të tjerë që kanë përfunduar të njëjtin fakultet dhe të njëjtin program studimi vetëm një vit më parë, në vitin 2013, e kanë të njohur diplomën si “Master Profesional”. Ky ndryshim në emërtim ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta në trajtimin financiar, pasi kolegët që kanë mbaruar një vit më herët përfitojnë pagë me bazë 120, ndërsa ne paguhemi me bazë 100, ndonëse kemi të njëjtën ngarkesë akademike dhe përmbajtje studimi.

Kjo situatë është thellësisht e padrejtë, sepse shumë prej nesh kemi mbi 30-40 vite përvojë pune në arsim dhe kemi ndjekur studimet universitare në të njëjtat kushte dhe me të njëjtin nivel akademik si kolegët tanë. Për këtë arsye, ndryshimi në titullin e diplomës vetëm për shkak të vitit të përfundimit të studimeve krijon diskriminim në trajtimin profesional dhe financiar. Kemi kërkuar

sqarime pranë zyrës së financës dhe na është thënë se “kështu figuron në dokumente”, pa dhënë një zgjidhje konkrete”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, si dhe marrjen e masave, si më poshtë:

- *Për verifikimin e rastit të krijuar në lidhje me njohjen e diplomave të Fakultetit të Edukimit të Prishtinës (dega Gjakovë);*
- *Për rekomandimin e ndërhyrjeve të nevojshme pranë institucioneve përgjegjëse për të garantuar trajtim të barabartë në pagë dhe njohje të kualifikimit profesional.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimorë ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet *ndaj çdo veprimi apo mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

Në ankesën objekt shqyrtimi znj. G. M, pretendon se është diskriminuar nga ana e Ministrisë së Arsimit, për shkak të gjendjes arsimor dhe çdo shkak tjetër.

Në nenin 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, parashikohet se: *“Ankesa nuk pranohet kur: (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”*. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Referuar informacionit të cituar në formularin e ankesës, rezulton se ankuesja ka përfunduar studimet e larta pranë Fakultetit të Edukimit, Qendra Gjakovë, në Universitetin e Prishtinës në vitin 2014. Po në të njëjtin vit, pra në 2014, i është njësuar diploma nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në atë kohë, sipas programit Bachelor.

Pretendimi i ankuses, paraqitur pranë Komisionerit, lidhet me faktin që kolegë të saj, të cilët kanë përfunduar të njëjtin fakultet në vitin 2013, atë të Edukimit, Qendra Gjakovë, në Universitetin e Prishtinës, janë trajtuar në mënyrë më të favorshme nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (së asaj kohe), duke ju njohur diploma “Master Profesional”.

Për këtë arsye, ankuesja i është drejtuar Komisionerit, duke pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes arsimore dhe çdo shkak tjetër, nga ana e Ministrisë së Arsimit, duke qenë se njohja e diplomës “Bachelor” në vitin 2014, i ka sjellë pasoja duke u paguar më pak nga kolegët e saj të ndodhur në të njëjtat kushte, si dhe duke mos iu njohur si “Master Profesional”.

Në këtë kuptim, evidentohet se situata e pretenduar e diskriminimit ka ndodhur në vitin 2014, si dhe ajo ka marrë dijani lidhur me të po në të njëjtën periudhë, në vitin 2014, kur i është bërë njësimi i diplomës nga ana e Ministrisë së Arsimit të asaj kohe.

Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është 19.11.2025. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton më shumë se 3 (vjet) nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijani mbi diskriminimin e pretenduar, daton më shumë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 269, datë 21.11.2025 pranë KMD-së.

Pra, konkludojmë se janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se LMD, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: *“Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës”*.

¹ Për analogji shih vendimet nr. 167, datë 23.08.2023; nr. 158, datë 28.05.2024; nr. 56, datë 12.03.2025, nr. 118, datë 12.05.2025 dhe nr. 218, datë 22.09.2025 të Komisionerit.

Nga ana tjetër, LMD, në nenin 36, pikat 1, 3, 4, të tij, parashikon se: “1. Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34² të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”.

.....

3. Gjykata e njofton Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim.

4. Gjykata mund t'i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen.”

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “dh” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 269, datë 21.11.2025, të paraqitur nga znj. G. M, kundër Ministrisë së Arsimit, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

² “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”.